

VENDIM
Nr.106, datë 23.6.2011

PËR MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJET LIGJORE,
ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT PËR ZBATIMIN E
VENDIMIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NR. 24,
DATË 9.6.2011

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit dhe në zbatim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr.24, datë 9.6.2011,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e propozimit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, bashkëlidhur, për zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 9.6.2011 për ripërtëritjen e përbërjes së Gjykatës Kushtetuese çdo tre vjet në një të tretën e anëtarësisë së saj.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)